

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 34/2019, “PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në kuadër të ndryshimeve ligjore që po ndërmerren për përfshirje në objektin dhe qëllimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, jo vetëm të pasurive të sekuestruara/konfiskuara nga organet e drejtësisë, por edhe të pasurive të sekuestruara/konfiskuara me vendime të pushtetit vendor apo organeve të tjera, ndër to edhe ndërtimet pa leje, si dhe referuar numrit gjithnjë e në rritje të vendimeve të sekuestrimit/konfiskimit të pasurive të luajtshme e të paluajtshme nga organet kompetente, apo të pasurive të llojit “*Kriptomonedha*” (*monedha virtuale*), propozohet ky projektligj, me masa dhe me synimin e garantimit të një mirëadministrimi, përmes përmirësimit të bazës ligjore aktuale.

Objektivat të cilat synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji, kanë të bëjnë me miradministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, jo vetëm nga aktet e organeve të drejtësisë, por edhe të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga akte të organeve administrative, pushtetit vendor, siç janë edhe ndërtimet pa leje, duke mundësuar rikthimin në komunitet të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

Këto qëllime dhe objektiva synojnë të krijojnë një sistem më të mirë administrimi të pasurive të sekuestruara/konfiskuara, duke forcuar mbrojtjen e interesave publike dhe kthimin në komunitet në mënyra të ndryshme të përfitimeve të arritura.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji vjen si rrjedhojë e reformës gjithëpërfshirëse qoftë për territorin, nga përdorimi eficient i ndërtimeve pa leje të konfiskuara, ashtu edhe për mirëadministrimin e pasurive *si monedhat virtuale*, të cilat ndikojnë drejtëpërsëdrejti në rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit e në vijim, të përdorimit të tyre për interes public dhe social.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji parashikon bashkëveprimin dhe bashkërendimin e proceseve të sekuestrimit/konfiskimit, qoftë me organet e drejtësisë, ashtu edhe me organet e tjera administrative apo të pushtetit vendor.

Një nga problematikat kryesore që rregullon ky projektligj, e në vijim plotësimi me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, është përcaktimi i rregullave të administrimit të pasurive të llojit monedha virtuale, të cilat herë pas here kanë qenë një sfidë për këtë institucion, referuar problematikave të hasura.

Në aspektin procedural, ky projektligj minimizon kohën dhe afatet e shitjes së pasurive të sekuestruara/konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke sjellë përfitime në rritjen e të ardhurave, si të agjencisë, ashtu edhe të buxhetit të shtetit dhe fondeve të posacme, të cilat shërbejnë ndër të tjera, për shërbime të ndryshme sociale dhe institucionale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 34/2019 “*Për administrimin e pasurive të paluajtshme*”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *acquis* TË BASHKIMIT EVROPIAN

Projektligji nuk ka qëllim përafrimin me *acquis-në* e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj është i përbërë nga 14 nene.

Relacion shpjegues për projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”*”, të ndryshuar.

Në nenin 1, 3, 4 dhe 10, qëllimi dhe objekti i ligjit për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, është jo vetëm administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë, por dhe ato të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organe të tjera administrative dhe pushteti vendor.

Në nenin 2 dhe 5, parashikohet një term i ri që është: *“Fondi i posaçëm i dedikuar për ndërtimet pa leje”*, i cili do të shërbejë për veprimtarinë / zhvillimin e objekteve pa leje që janë konfiskuar dhe i kanë kaluar në administrim AAPSK sipas përcaktimeve ligjore.

Në nenin 9 parashikohet *“Monedha virtuale”*, si një pasuri e re, e luajtshme, që vitet e fundit është shtuar në listën e pasurive të cilat sekuestrohen/konfiskohen nga organet e drejtësisë.

Në nenin 6,7 dhe 9, përcaktohet AAPSK dhe Kryeadministratori për të kryer procedurat e shitjes për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe për të lidhur në vijim kontratat përkatëse, referuar ligjit për ankandin publik. Në funksion të përmbushjes së misionit të saj ligjor për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka zhvilluar ndjeshëm kapacitetet e saj institucionale, administrative dhe teknike. Në kuadër të kësaj rritjeje funksionale, është vlerësuar e arsyeshme që procesi i shitjes së pasurive që agjencia administron, të kryhet tashmë nga vetë institucioni, për arsye si vijon:

- Agjencia mban përgjegjësi ligjore dhe faktike për ruajtjen, vlerësimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e përkohshëm të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Duke qenë se administrimi i plotë i këtyre pasurive përfshin edhe fazën e shitjes, është e arsyeshme dhe logjike që i njëjti institucion që i menaxhon t’i çojë deri në fund edhe procedurat e shitjes, për të garantuar koherencë, transparencë dhe përgjegjësi të unifikuara në çdo fazë të procesit.
- Përfshirja e një institucioni të dytë në proces, ka krijuar deri më sot vonesa të ndjeshme në përmbylljen e procedurave të shitjes dhe kalimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Kryerja e procesit nga vetë Agjencia do të mundësojë menaxhim më të shpejtë të aseteve, reduktim të burokracive dhe rritje të efikasitetit financiar. Transferimi i funksioneve të shitjes tek Agjencia shmang duplikimin institucional, ul kostot administrative dhe mundëson përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe financiare. Në vend të dy institucioneve që

kryejnë veprime të njëpasnjëshme për të njëjtin proces, përgjegjësia përqendrohet në një ent të vetëm.

- Njihen shumë praktika ku, agjencitë homologe për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara ushtrojnë vetë proceset e shitjes, si pjesë e zinxhirit të plotë të administrimit. Kjo siguron transparencë, gjurmueshmëri dhe menaxhim profesional të ciklit të plotë të pasurisë — nga sekuestrimi, deri në shitje dhe transferim të të ardhurave.

Në nenin 8 parashikohet “*Monedha virtuale*”, si një pasuri e re, e luajtshme, që vitet e fundit është shtuar në listën e pasurive të cilat sekuestrohen/konfiskohen nga organet e drejtësisë.

Në nenin 11, tek përbërja e shpenzimeve për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, shtohet çdo shpenzim i domosdoshëm për administrimin e pasurive të konfiskuara si ndërtime pa leje, si rezultat i përfshirjes së kësaj tipologjie pasurie, në këtë ligj.

- Gjithashtu, përcaktohet që, për procedurat e administrimit të pasurive në masë “*sekuestro*”, shpenzimet realizohen mbështetur në studim tregu. Kjo gjë, vjen si pasojë e faktit që për pasuritë e sekuestruara, tipologjia, numri, sasia, problematika që ato sjellin dhe masat që duhen marrë për administrimin dhe menaxhimin e tyre, janë të pa parashikuara, për faktin se nuk mund të paracaktohet ecuria e hetimeve nga organet e drejtësisë, data e zbardhjes së vendimeve përkatëse dhe përcjellja pranë strukturave të agjencisë përgjatë një viti kalendarik.
- Në momentin që një pasuri e sekuestruar merret në dorëzim nga AAPSK, nuk mund të parashikohen problematikat apo nevojat që kjo pasuri mund të ketë. Vlen të theksohet që në shumë raste, problematikat e pasurive kanë bërë të pamundur marrjen në dorëzim të tyre, pasojë e cila reflektohet në dëm të interesave të shtetit.
- Këto shpenzime, mbulohen nga të ardhurat e agjencisë, të cilat depozitohen në llogari bankare në bankat e nivelit të dytë dhe vinë si rrjedhojë e depozimit të qirave mujore të pasurive që agjencia administron, shitjeve apo të ardhurave të tjera dhe nuk janë pjesë e fondit buxhetor në momentin e depozitimit të tyre (deri në një vendim/masë të dytë).

Në nenin 12, përcaktohen aktet nënligjore që duhet të nxirren në zbatim të nenit 8, pika 5 të projektligjit.

Në nenin 13, përcaktohet hyrja në fuqi e ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij Projektligji janë: Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Projektligji u hartua nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe do të përcillet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Energjisë dhe Infratrakturës dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk parashikon efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI

Albana Koçiu